

MI-610 AQUASEAL

Hidroizolues elastik, dy komponentësh, për mbrojtje nga uji me bazë cemento, i modifikuar me polimer.



PAKETIMI
24kg + 8kg



**RAPORTI I
PËRZIERJES**
8kg/24kg



KONSUMI
1.7 kg/m²

Përshkrimi

MI-610 AQUASEAL është një hidroizolues elastik, dy komponentësh, për mbrojtje nga uji me bazë cemento, i modifikuar me polimer. Ka rezistencë të lartë ndaj kripërave për aplikime brenda dhe jashtë dhe punueshmëri të mirë.

Fushat e Përdorimit

- Përdoret për mbrojtje nga uji për pishina, hamame, banja, dushe, ballkone, tarraca para vendosjes së pllakave të qeramikës.
- Përdoret për mbrojtje nga uji për puset e betonit të ujit të pijshëm.
- Përdoret për mbrojtje nga uji për elemente betoni nën tokë si themelet, muret mbajtës dhe muret e bodrumeve.
- Përdoret për mbrojtje nga uji për vende që janë të ekspozuara ndaj deformimeve, trafikut të njerëzve dhe të ngarkesave.

Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë pa pluhur, yndyrë, bojë, etj. Rekomandohet ta lagni para aplikimit. Përdorni MP-809 ACRYPRIME për të rritur ngjitjen e MI-610 AQUASEAL me sipërfaqen.

Aplikimi

Përzieni të gjithë përmbajtjen e thesit 24 kg (komponenti A) me 8 kg të komponentit të lëngshëm B.

Aplikohet një shtresë e hollë e MI-610 AQUASEAL me furçë, rul ose mallë, pastaj pas 5-6 orësh aplikohet një shtresë e dytë për të arritur një trashësi finale prej rreth 2-3 mm. Vendosi një rrjetë 4.5 x 4 mm në shtresën e parë të MI-610 AQUASEAL kur punoni rreth nyjeve të zgjerimit, nyjeve mes sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, vendeve me ndarës të vogla ose vendeve që janë të ekspozuara ndaj presionit. Pasi të vendoset rrjeta, aplikohet një shtresë e dytë e MI-610 AQUASEAL kur e para të jetë tharë (pas 5-6 orësh).

Konsumi

Konsumon 1.7 kg/m², në varësi të sipërfaqes.

Karakteristika



Të dhëna teknike (NE +23 °C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur + Lëng
Ngjyra	Gri
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	8 kg Leng / 24 kg Pluhur
Konsumi	1.7 kg/m ²
Koha e punueshmërisë	2 Orë
Densiti	1900 ± 100 kg/m ³
Forca e ngjitjes (EN 1542)	≥ 1 N/mm ²
Forca e ngjitjes pas ciklit pa ndikim të kripërave (EN 13687-3)/ (EN 1542)	≥ 1 N/mm ²
Forca e ngjitjes pas nxehtësië (EN 1062-11/ EN 1542)	≥ 1 N/mm ²
Absorbimi kapilar i ujit (EN ISO 1062-3)	< 0.1 kg/m ² h ^{0.5}
Rezistenca ndaj nxehtësisë	(-30°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	Bs1d0
Lëshimi i substancave të rrezikshme	Shiko SDS

MATIS Construction Chemicals

Tiranë, Albania

info@matís-eu.com

www.matis-eu.com

T: +355 69 20 94 570